



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/02-4802

Dt.02.06.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Shkelzen (Karamon) Hoxha** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në bodrum, përdhese dhe katin e parë – FAZA E PARË, me etazhitet për fazën e parë B+P+2, ndërsa etazhiteti i përgjithshëm i objektit B+P+5, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: Shkelzen (Karamon) Hoxha nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në bodrum, përdhese dhe katin e parë – FAZA E PARË, Sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues Urban të potezit përgjatë rrugës “Nëna Tereze” nga Gjykata Komunale deri te Ura e Islom Begut” dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 07/351-2689, të datës 04.08.2012, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 5791/1, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të lartë përmendurit, në rrugën “Nëna Tereze”, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit për FAZËN E PARË është B+P+2, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) te objektit për këtë fazë **S=416.33 m²**

Bodrumi:	(Sip.Bruto):	S=101.67 m²
Përdhese:	(Sip,Bruto):	S=97.16 m²
Kati i parë:	(Sip,Bruto):	S=105.19 m²
Kati i dytë:	(Sip,Bruto):	S=112.31 m²

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim - objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në bodrum, përdhese dhe katin e parë, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë byroja projektuese “Real - PROJECT” - Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Shkelzen (Karamon) Hoxha, me banim në rrugën “Nëna Tereze”, nr. 28, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/02-4802, dt. 08.03.2017, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në bodrum, përdhes, dhe katin e parë – FAZA E PARË, me etazhitet për fazën e parë B+P+2, ndërsa etazhiteti i përgjithshëm i objektit B+P+5, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 5791/1, ZK:,Gjakovë - Qytet, në pronësi të lartë përmendurit, në rrugën “Nëna Tereze” siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:1 000 , të datës 11.06.2012, i punuar nga NSH”G&L79-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 02.09.2016, në pronësi të Shkelzen (Karamod) Hoxha, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me nr.të lëndës 1515/16, të datës 02.09.2016, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit banimor shumë banesor në me afarizëm në përdhese, me nr. 351-2689, në ngastrën kadastrale me nr. 5791/1 :ZK: Gjakovë-Qytet, me të datës 04.08.2016.
5. Raporti mbi kërkimet gjeomekanike në teren si dhe kërkimet laboratorike në lokacionin e parashikuar për ndërtimin e objektit afaristo banesor, me Investitor Shkelzen Hoxha nga Gjakova, në ngastrën kadastrale me nr.995, të hartuar nga “Geomerkur”Sh.p.k.Gjakovë.
6. Lejen Urbanistike me nr. 07-351-2681, dt.02.211.2012, lëshuar nga DUMM.
7. Deklaratë Pëlqimi Notal, me nr.LRP.NR.1154/2017, dt.13.04.2017.
8. Deklaratën e datës 03.12.1990, të vërtetuar nga Komuna e Gjakovës.
9. Aktvendimin – Lejen Ndërtimore me nr. 05-351-300/91, dt.12.05.1993, të lëshuar nga Drejtorati për Urbanizëm, Punë Komunale e Strehimore, ndërtimore dhe mbrojtjen e ambientit të njeriut i komunës së Gjakovës.
10. Aktvendim-Leja ndërtimore me nr 5-351-300/91, dt. 07.03.1995, të lëshuar nga Drejtorati për Urbanizëm, Punë Komunale e Strehimore, ndërtimore dhe mbrojtjen e ambientit të njeriut i komunës së Gjakovës.
11. Aktvendimin – Leja ndërtimore me nr. 05-351-300, dt.18.04.1991, nga Sekretairati për Urbanizëm, punë strehimore i komunës së Gjakovës.
12. Pëlqimin Sanitar, me nr 14/53/50333 të datës 27.12.2017, nga Inspektoriati Sanitar komunal-Drejtoria për Punë Inspektuese.
13. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.229/12, me datë 15.12.2016, lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Ministria e Punëve të Brendshme e R.K.S.
14. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-C-222 të datës 05.02.2017.7
15. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, dt. 17.07.2012.
16. Pëlqimin nga K.R.U.”Radoniqi”Sh.A.-Gjakovë, të datës 10.06.2016.
17. Pëlqimin nga PTK-Sh.A.Gjakovë, të datës 06.07.2016.
18. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Postën e Kosovës, filiala në Gjakovë, të datës 23.05.2017.
19. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga ndërmarrja projektuese “Real – PROJECT” - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 1069.96 Euro.


KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit ,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani, jur.dipl.

U. D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.




Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë

KOPJE PLANI

Zona kad. GJAKOVË - QYTET

Shk. zvog. 1: 2500

Poseduesi: HOXHA SHKELZEN (KARAMON)



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m	
5791-1			SHITËPI - NDER			1	20	
Gjithësejtë						1	20	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër
duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

P.nr. 995

Punoi : N.Sh."G & L" - 79
DEBITORI.